

Neni 1

Në nenin 2, “paralajmërimet e përgjithshme dhe mesazhet informuese në produktet e duhanit”, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) a) Pika 3, ndryshohet si në vijim:

“3. Për paketat në formë kuboide, vetëm një nga paralajmërimet shëndetësore të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni duhet të shfaqet në pjesën e poshtme të njëres prej sipërfaqeve anësore të njësisë së paketës. Paralajmërimi shëndetësor ose mesazhi informues duhet të zërë jo më pak se 50% të sipërfaqes anësore në të cilën është printuar. Për produktet e duhanit, që nuk janë të vendosura në paketim kuboid, mesazhet duhet të shfaqen në atë pjesë të paketimit që garanton vizibilitet të plotë të paralajmërimit. Paralajmërimet e përgjithshme dhe mesazhi informues do të rrotullohen në mënyrë të tillë që të sigurohet shfaqja e tyre në mënyrë të rregullt.”

b) Në fund të pikës 5, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Sipërfaqja e paralajmërimeve të përgjithshme dhe mesazhet informuese do të rrotullohen në mënyrë të tillë që të sigurohet shfaqja e tyre në mënyrë të rregullt. Sfondi i paralajmërimeve të përgjithshme do të jetë i rrethuar nga një bordurë e zezë, e cila do të jetë 1mm brenda hapësirës së parashikuar për secilin paralajmërim. Bordura nuk duhet të ndërhyjë në asnjë mënyrë tek përmbajtja e paralajmërimeve.”

Neni 2

Në nenin 3 “Paralajmërimet shëndetësore të kombinuara për produktet e duhanit” bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. në rastet kur pulla e akcizës e përdorur për qëllime fiskale vendoset në skajin e sipërm të një paketimi, paralajmërimi i kombinuar shëndetësor që do të shfaqet në sipërfaqen e pasme mund të pozicionohet direkt nën pullën e akcizës.”

b. Pas pikës 7, shtohet pika 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

“8. Paralajmërimet e kombinuara do të rrotullohen në mënyrë të tillë që të sigurohet shfaqja e tyre e rregullt, duke zbatuar kombinimet e përcaktuara në shtojcën 3 të këtij vendimi.

9. Sipërfaqja e paralajmërimeve të kombinuara do të jetë i rrethuar nga një bordurë e zezë, e cila do të jetë 1mm brenda hapësirës së parashikuar për secilin paralajmërim. Bordura nuk duhet të ndërhyjë në asnjë mënyrë tek përmbajtja e paralajmërimeve.”

Neni 3

Paralajmërimet shëndetësore për purot dhe cigarillot

1. Paralajmërimet shëndetësore për produktet e duhanit për tymosje përveç cigareve, duhanit me dredhje dhe duhanit për nargjile.
2. Paralajmërimi shëndetësor duhet të shfaqet në dy sipërfaqet më të mëdha të njësisë së paketës dhe të çdo paketimi të jashtëm.
3. Paralajmërimi shëndetësor duhet të zërë 30% të sipërfaqes së njësisë së paketës dhe të çdo paketimi të jashtëm.
4. Paralajmërimi shëndetësor duhet të respektojë kërkesat e specifikuara në nenin 2, pika 5, të këtij vendimi. Paralajmërimi shëndetësor do të rrethohet nga një bordurë e zezë, e cila do të jetë jo më pak e 1 mm dhe do të jetë jashtë sipërfaqes së rezervuar për paralajmërimet shëndetësore. Teksti i paralajmërimit shëndetësor duhet të jetë paralel me tekstin kryesor të vendosur në sipërfaqen e dedikuar për këto paralajmërimet.
5. Në rastet kur paralajmërimi nuk mund të printohet me makineri për shkak të proceseve prodhuese atëherë paralajmërimi mund të shtypet në një etiketë dhe të ngjitet në paketim, me kusht që të jetë i pa lëvizshëm.

Neni 4

Në Vendimin Nr. 7, datë 19.02.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të fotove të paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit, si dhe specifikimet e vendosjes së tyre në paketë”, fotot me Nr. 1, 2, 11 dhe 13 shfuqizohen.

Neni 5

Pas nenit 10, shtohet neni 11 me këtë përmbajtje:

"Neni 11

Dispozita tranzitore

1. Produktet e duhanit që nuk plotësojnë kushtet e këtij vendimi nuk do të lejohet të importohen apo prodhohen pas datës 05.03.2022, por do lejohen të tregtohen në pikat e shitjes të pakicës deri në datën 05.06.2022.
2. Prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit do të lejohen të importojnë, prodhojnë dhe shesin produktet e duhanit në përputhje me kërkesat e këtij vendimi dhe përpara datës 05.03.2022 në mënyrë që të mundësohet një tranzicion sa më efikas nga paketimet aktuale në paketimet me kushtet e reja të parashikuara në këtë vendim.”